

Duhet vullnet politik që të zgjidhet çështja e emrit IRJM, ka porositur Federika Mogerini përfaqësuesja e ardhshme për politik të jashtme dhe siguri të BE-së.

“Rrezikojmë nëse i ndajmë problemet, nëse nuk punojmë për integrimin e këtyre vendeve. Prioritet numër një është B&H, pas zgjedhjeve vendi të dalë nga kriza. Në aspektin teknik bisedat Serbi – Kosovë po shkojnë mirë, por duhet edhe në aspekt politik. Shqipëria ka gjasa unike për reforma, ndërkaq Mali i Zi është e para në listë për progres drejt BE-së. Sa i përket IRJM-së dhe çështjes së emrit, besojë se duhet vullnet politik për zgjidhjen”, kujton Mogerini.